



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:282242

Datë: 16.02.2024

Numri i dokumentit: 05338961

CPP.nr.139/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Izet Gërguri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit SH.A. KUR “M...” J.S.C. me seli në Mitrovicë, kundër debitorit A.K nga Vushtrria, duke vendosur sipas propësimit të debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat A.M në Vushtrri, P.nr.129/23 të datës 05.04.2023, jashtë seancës, me datën 16.02.2024, e mori këtë këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET propësimi i debitorit A.K nga Vushtrria i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit të përmbaruesit privat A.M në Vushtrri, P.nr.129/23 të datës 05.04.2023 si i pa bazuar.

A r s y e t i m

Kreditori SH.A. KUR “M...” J.S.C. me seli në Mitrovicë, në bazë të dokumentit të besueshëm, Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste (Kartelës financiare të konsumatorit) ka parashtruar propozim për përmbarim pranë Përmbaruesit Privat A.M në Vushtrri, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet debitori A.K nga Vushtrria që në emër borxhit për periudhë prej 01.01.2022 deri me datën 31.03.2023 t’ia paguaj shumën prej 1,257.93 euro, me kamatë ligjore, vjetore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës.

Përmbaruesit privat A.M në Vushtrri, me urdhrin P.nr.129/23 të datës 05.04.2023 e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar propësim kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit të përmbaruesit privat duke e kundërshtuar në tërësi të njëjtin, me pretendimet se borxhi i kërkuar nga ana e kreditorit është i pabazuar, i paargumentuar, se debitori nuk ka pranuar asnjëherë fatura nga kreditori. Tutje debitori ka shtuar se borxhi i kërkuar nga kreditori është borxh i parashkruar konform nenit 360 të LMD-së, ashtu që, gjykatës i ka propozuar që propësimin e debitorit t’a aprovoj si të bazuar dhe urdhrin përmbarimor të përmbaruesit privat t’a anuloj në tërësi.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në propësim duke theksuar se propozimi për përmbarim është paraqitur konform nenit 29 të LPP-së, ndërsa lidhur me parashkrimin e borxhit, kreditori ka shtuar se borxhi nuk është parashkruar, ndërsa lidhur me pretendimin e debitorit për mospranimin e faturave, kreditori thekson se nuk kanë pranuar asnjë ankesë nga debitori për këtë çështje duke propozuar gjykatës që propësimin e debitorit t’a refuzoj si të pabazuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të prapësimit të debitorit dhe përgjigjes në prapësim nga ana e kreditorit e në raport me provat në shkresat e lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se nuk ekziston asnjë nga shkaqet e prapësimit sipas nenit 71 të LPP-së.

Sipas vlerësimit të gjykatës, dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, pra, Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste (Kartela financiare e konsumatorit) është dokument i besueshëm konform nenit 29, par. 1, pika 1.2 të Ligji 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore ku parashihet *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave: dhe po ai ekstrakt, bazuar në nenin 29 par.3 i cili parasheh “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.”* është i përshtatshëm për përmbarim pasi që në të njëjtin është treguar kreditori, debitori, objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes.

Po ashtu, propozimi për përmbarim është paraqitur konform nenit 37, i Ligji 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore i cili parasheh *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* dhe nenit 38 par.1, të pot ë njëjtit ligj, cili parasheh *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.”*, pra, propozimi për përmbarim përmban të gjitha të dhënat e kërkuara me nenin 37 dhe 38 par.1 të LPP-së

Pretendimin e debitorit se borxhi i kërkuar nga kreditori është parashkruar, gjykata e refuzoi si të pabazuar, ashtu që, bazuar në provat në shkresat e lëndës, Gjykata gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori për periudhën 01.01.2022 deri me datën 31.03.2023 në shumë prej 1,257.93 **Euro**, është i bazuar dhe se nuk është parashkruar duke pasur parasysh se me nenin 360, par.1, nën par. 1.1 Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve ku parashihet *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, ndërsa sa i përket rrjedhjes se afatit të parashkrimit, në nenin 360, par.2 të njëjtit ligj parashihet *“Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”*, pasi që kreditori me paraqitjen e propozimit për përmbarim me datën 05.04.2023 ka ndërprerë rrjedhjen e afatit të parashkrimit për kërkesat e arritura gjatë vitit 2022 dhe 2023.

Andaj, gjykata, nga arsyet e cekura më lart, bazuar në nenin 43.4, në lidhje me nenin 71 dhe 73 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
CPP.nr.139/23, datë: 16.02.2024

Gj y q t a r i
Izet Gërguri

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta e ankesës në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.